

- Personat, të cilëve u është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore, të intelektit, psikike/mendore, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje, të perkohshme apo të përhershme, që nuk vijnë nga shkaqe, që lidhen me punësimin, e vërtetuar kjo nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar.
- Personat paraplegjikë e tetraplegjikë, të cilët deklarohen, me vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), se janë të tillë, pavarësisht nga shkakut dhe mosha, përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar.
- Personat me aftësi të kufizuara, të përcaktuar në pikat 1 e 2, të këtij vendimi, të cilët, me vendim të komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë, përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë edhe një kujdestar me pagesë.
- Vlerësimi i gjendjes mjekësore të personave me aftësi të kufizuara, të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, bëhet nga KMCAP-i, i cili është i ngritur dhe funksionon pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ku merr pjesë, si anëtar me të drejtë vote, edhe mjeku, punonjës i Shërbimit Social Shtetëror.
- Invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi. Kriteret e dhënies së dëshmisë dhe forma e saj përcaktohen në rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Shërbimit Social Shtetëror.
- Kriteret mjekësore për vlerësimin e aftësisë së kufizuar përcaktohen në rregulloren e miratuar nga ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Mirëqënies Socialë dhe Rinisë.